

VALTER MEMISHA

**FRAZEOLOGJIA NGA *EPOSI I KRESHNIKËVE*
TE FJALORI SHPJEGUES**

Një fjalor i mirë shpjegues, normativ apo jo i tillë, realizohet e vlerësohet kur pasqyron apo përzgjedh lëndë leksikore, frazeologjike dhe semantike nga të gjitha burimet e mundshme ligjërimore të një gjuhe. Duke iu referuar veprave të hartuara institucionalisht, shqipja ka në përdorim fjalorë të tipit të mesëm në të me një pasuri që shkon deri në 50.000 fjalë. Me ndonjë përjashtim (që kërkon vëmendjen e nevojshme) ky numër lemash e ruan këtë sasi edhe te fjalorët e tjerë njëgjuhësh që nuk janë hartuar nga leksikografë profesionistë dhe institucionalisht apo edhe te fjalorët dygjuhësh, ku shqipja sillet si gjuhë e parë.

Pa rënë në përsëritje, procesi i hartimit të fjalorëve është i përhershëm dhe asnjëherë nuk mund të pasqyrojë gjithë pasurinë leksiko-semantike që është në përdorim. Burimet e për lëndën leksikografike në ditët e sotme lidhen me kartoteka manuale apo referohen te databeize / korpusë gjuhësore elektronike. Fjalorët e shqipes, në mungesë të një databeizi të plotë apo afërsisht të plotë (një nocion gjithmonë relativ, sepse është i hapur për prurje), janë hartuar përgjithësisht me lëndë nga *Kartoteka e leksikut të shqipes*. Kjo numëron sot rreth 6.000.000 njësi leksiko-semantike që vijnë nga ligjërimet e shkruara dhe të folura të shqipes në rrafshin kohor dhe atë hapësinor, duke u skeduar dhe u sistemuar vjelje thuajse nga gjithë produkti shkrimor i shqipes në shekuj dhe nga ligjërimet gojore thuajse nga të gjitha hapësirat shqipfolëse.

Një burim i pasqyrimin të lëndës leksikore në fjalorë dhe një hapësirë me peshë për ta pasuruar këtë lëndë mbetet edhe folklori. Ne me vetëdije iu drejtuam *Epikës legjendare* për të qëmtuar njësi frazeologjike që mund të gjallojnë aty, si dhe vendin që këto njësi kanë zënë në kartotekën tonë si institucion dhe prej këtej në fjalorët shpjegues apo dygjuhësh të shqipes së sotme. Bëmë vjelje frazeologjike nga vepra “Epika Legjendare e Rugovës”, II, kolana “Këngë të kreshnikëve dhe balada”, botim i vitit 2011, IAP, Kosovë. Vëllimi përfshin një lëndë të dëgjuar drejtpërdrejt nga lahutari Isuf Selman Kuklecaj (1908-1989) dhe të regjistruar audio nga punonjësi shkencor i IAP (Instituti Albanologjik i Prishtinës), Zymer Neziri. Ai ka ndjekur nga afër edhe transkriptimin e botimin e saj.

Për se iu drejtuam Epikës legjendare dhe më konkretisht pse kësaj vepre? Shtysën e kemi marrë, ndër të tjera, dhe nga parathënia e vëllimit, të shkruar nga studiuesi Shaban Sinani, se “Epika heroike e Rogovës, e botuar besnikërisht nga Zymer Neziri, ashtu si bartet prej subjekteve të gjalla: besnikërisht në leksik, në frazeologji, në fonetikë e fonologji, mund t’i shërbejë historisë së gjuhës, historisë dhe shtresimeve të huajtjes së fjalëve të huaja (veçanërisht të sllavizmave e të orientalizmave), historisë së përveçimit të shqiptarëve ndaj të tjerëve, historisë së besimeve, historisë së kulturës e të qytetërimit dhe historisë së përfitimit të ndikimeve prej traditash të tjera gojore”¹.

Çfarë na ka tërhequr vëmendjen te pasuria e vjelë?

a. Nga një përjasje me pasurinë leksikore (fjalësore), vërejmë se numri i njësive frazeologjike në këtë botim është relativisht shumë më i vogël. Ne kemi vjelë në 320 faqe rreth 1200 njësi, me një mesatare prej 4 njësish për faqe, sasi kjo që bie jo pak, sepse shumë njësi përsëriten apo dalin si variante të njëra tjetrës, sepse jo pak këngë dalin në dy a më shumë regjistrime. Gjithashtu shkaku i numrit të vogël të njësive frazeologjike, krahasuar me numrin e fjalëve, mendojmë se duhet kërkuar te natyra e narracionit epiko-legjendar. Dihet që njësia frazeologjike është përgjithësisht një shndërrimi i figurshëm i një togfjalëshi / i një sintagme të lirë, një proces ku figurshmëria shpërfaqet edhe si ngjyrim emocionues / si konotacion, i cili është pjesë përbërëse e pandashme e kësaj njësie. Por rrëfimi epiko-legjendar, edhe pse karakterizohet nga zmadhimi / hiperbolizimi i portretit fizik dhe i bëmave të heronjve, përgjithësisht ruan një asnjësi emocionuese dhe karakterizohet nga përdorimi i fjalëve në kuptimin e tyre të drejtpërdrejtë e të parë, duke iu mënjeluar ndërtimit të konstrukteve të figurshme, pra duke e mënjeluar dukshëm frazeologjinë.

b. Njësitë frazeologjike që kanë zënë vend në rrëfimin epiko-heroik, pra edhe në përmbledhjen “Epika Legjendare e Rugovës”, II, kolana “Këngë të kreshnikëve dhe balada”, kanë vlera të drejtpërdrejta shënuese. Një pjesë e madhe e tyre gati-gati nuk ndjehen si njësi frazeologjike.

Ani, e rakia, po n’llafe o-j ka çelë
Ani, e kanë marrë llafin, po llafojnë
Ani, llaf po ban, po Bylykbash-e Muji

¹ Sh. Sinani, *Epika heroike si etnotekst*, Parathënie e “Epika Legjendare e Rugovës”, II, Kolana këngë të kreshnikëve dhe balada, IAP, Kosovë, 2011, f. 10.

Ani ç’e livdon, more, veten për trimni!

(f. 49)

c. Dihet se karakteristika kryesore e epikës legjendare është veprimi, lëvizja, ndeshja me fjalë e me armë. Dhe kjo semantikë mbartet përmes foljeve e panumërta që mund t’i vëresh në çdo këngë. Madje mund të themi se nuk ka varg pa folje, madje shpesh brenda tyre gjen më shumë se një të tillë. Ndaj krejt natyrshëm edhe numrin më të madh të njësive frazeologjike të nxjerra nga vëllimi që kemi pasur në dorë, e përbëjnë ato me vlerë foljore.

Ani, e dizgina, po ra i ka:

*Ani, merre, -thot’-, more **sherrin e ja pashë!***

Ani, po ta ap-e ni besë e të Zotit,

Ani, se përmas kjo n’dynjë s’ka me kthye!

(f. 52)

d. Në pasurinë frazeologjike të vjelë vërehet se vendin kryesor e zënë njësitë frazeologjike me foljen **bëj**, çka nënkupton se vatër kryesore semantike dhe motivuese për këto njësi mbetet gjymtyra e dytë. Aty ndodh shndërrimi i figurshëm që përgjithësisht është metaforik. Gjithashtu, kjo gjymtyrë shpesh mundëson krijimin e fjalëve të reja.

E shoqnia po n’kamë e janë çua,

*E **gryka-n’gryk’ e të tanë e kanë zanë,***

*Ani, e **për hajr e gazën po ja bajnë,***

*Ani, e **për hajr e nusen po ja bajnë.***

(f. 68)

d. Njësitë frazeologjike të vjela në përmbledhje mund të kenë dhe vlerën e një emri të një mbiemri apo të një ndajfoljeje.

f. Njësitë frazeologjike krijojnë një hapësirë interesante për të bërë vëzhgime edhe të natyrës jogjuhësore, si të rrafshit etno-kulturor, historik etj. Në vëllimin “Epika Legjendare e Rugovës” gjen topuzin, heshtën, por gjen edhe pushkën, gjen verën, por edhe rakinë e kafënë, gjen *kalin bagali*, *kalin kullash* apo dizgjinët e tyre, ashtu siç gjen edhe Mujin edhe Bylykbash Mujin, Sokol Halilin e Gjergj Elez Alinë. Pra, përfshihen elementet të legjendës me ato të historisë. Kujtojmë se në epikën legjendare Muji dhe Halili u ngujuan për jetë e mot në shpellë, në çastin që i qëlluan me pushkë, me armë zjarri, me mëtimin se tashmë burrëria qenka bjerrë dhe pabesia, plagimi, vrasja nga largësia apo jashtë logut / jashtë mejdanit të dyluftimit i paskan zënë vendin kësaj burrërie.

g. Interesante është se përmes frazeologjisë, mund të ndiqet dhe historia e vetë shqipes sepse aty gjen të shtresëzuara fjalë të huazuara nga gjuhët me të cilat ka kontaktuar shqipja në kohën kur ka lindur epika legjendare, por edhe më pas kur është kënduar prej lahutarëve, të cilët kanë shtuar jo pak fjalë të huazuara, duke e bërë perceptimin e ngjarjeve dhe të heronjve përmes komptencës vetjake leksikore. Studiuesi Shaban Sinani, në parathënien e vëllimit, shkruan se “kujtesa e eposit, së paku sa i përket vatrës paralele të Rugovës, ruan një gjendje hapjeje shumë më të madhe ndaj sllavizmave e orientalizmave sesa përfytyrohet në mendjen e puritanëve shqiptarë, të cilët nuk kanë shkas jashtë vetes për ta parë këtë dukuri si të frikshme: në fund të fundit, epika heroike shqiptare e Rugovës shenjon shkallën më të hapur të shqipes së vjetër ndaj gjuhës së dy mbretërive / perandorive kundërshtarë pushtuese.”²

h. Në pasurinë e vjelë kemi me dhjetëra njësi frazeologjike që kanë në përbërjen e tyre një huazim turk apo një orientalizëm tjetër që ka hyrë ligjërisht dhe nuk duhet asesi që të na shpjerë në përfundimin se epika legjendare e mbledhur në Rugovë ka lindur ose lidhet me një periudhë kohore historike, me atë të pushtimit otoman/ turk. Epika legjendare mbetet paraturke, madje kufiri kërkohet tek Beteja e Fushë-Kosovës në vitin 1389 dhe këto elemente të turqishtes a gjuhëve arabe nuk e kthejnë atë në epikë historike.

*Ani-o mirë selam-e, o, agve m'ka dhënë,
Ani, t'tanë selamin, po, n'kamë ja kanë marrë,
Ani-e qi në vet-e Talin e kam qitë,
Ani-e tanë habatë e po dhanë e ja kanë.*

(f. 50)

i. Në materialin e shfrytëzuar kemi shumë betime, si formula të gatshme etno-gjuhësore, që shpesh mbartin dhe elemente të frazeologjisë. Ato kanë vlerë të madhe për gjuhëtarin e për folkloristin, për historianin dhe antropologun sepse në to gjen shtresëzime të mendësisë që nga betimet pagane e deri tek ato që lidhen me besimet fetare që kanë njohur trojet ku gjallon apo është regjistruar kjo kolanë e epikës sonë legjendare. Është interesante, se në të gjithë elementet etnografike të betimit ndaj fuqisë

² Sh. Sinani, *Epika heroike si etnotekst*, Parathënie e Epika Legjendare e Rugovës”, II, Kolana “Këngë të kreshnikëve dhe balada”, IAP, Kosovë, 2011, f. 11.

supreme, kemi vetëm fjalën Zot, nuk shfaqet asnjëherë fjala Allah apo Perëndi etj.

*Ani-e, o vraje Zot, o bagali kullashin,
Ani-o, ka kurdisë e në thera e m'ka gjua!*
(f. 50)

j. Interesante nga ana gjuhësore është dhe ndjekja e dukurive të ndryshme sidomos në rrafshin strukturor të njësive frazeologjike gjatë përdorimit të tyre në mjedisin epiko narrativ. Kështu, vërejmë se jo rrallë, për efekt të ritmit të brendshëm, ndodhin prishje të rendit të gjymtyrëve:

*Ani-ej kan' marrë-e shami e unazë
Ani, e kanë fillua rrugën e kanë marrë.*
(f. 51)

*Ani, a m'digoni tridhet-e more shokë,
Ani, po un' me fjal e nusen e kam zanë*
(f. 52)

k. Shumë shpesh thyhen kufijtë e ngushtë të mirëfilltë të njësive dhe midis gjymtyrëve futen një a më shumë fjalë të tjera, që sillen si aktualizuese, si saktësuese a sqaruese të veprimit a të portretizimit të heroit, të kundërshtarit të tij a të mjedisit ku luftohet:

*Ani-e krejt të lik-e o, bre shokë, e m'ka ra,
Ani, sall, m'e pa ni çikë-o prej oxhakut...*
(f. 50)

Pjesa më e madhe e njësive frazeologjike të vjela, sidomos frazeologjia që motivohet me fjalë shqipe dhe me fjalë që përcaktojnë jetën, mjedisin etno-antropologjinë e shqiptarëve, ka zënë vend në fjalorët e shqipes bashkëkohore.

*“E, po pinë, o, venë-e me raki
Venë të kuqe e raki të bardhë,
Ani, vena e kuqe, po n'faqe u ka dalë”*
(f. 49)

*Ani, p'a m'digjoni-o tridhet morë agë,
Ani-o s'e kam lanë-o, për pare as për mallë
Ani, veç kur m'ra nër mendim m'e martua.*
(f. 50)

Ani-ej kan' marrë-e shami e unazë

Ani, e kanë fillua rrugën e kanë marrë.

(f. 51)

Ani, a m'digoni tridhet-e more shokë,

Ani, po un' me fjal e nusen e kam zanë

(f. 52)

Mbështetur edhe në këtë paraqitje të shkurtër të vendit të frazeologjisë vetëm në një botim për Epikën legjendare, vërejmë se frazeologjia është pjesë e pazëvendësueshme e realizimit të shprehjes gjuhësore popullore në këngët e kësaj fushe, në radhë të parë për vlerat emocionuese, shprehëse, por edhe shënuese. Kjo tregon se frazeologjia është përdorur shekuj me radhë, ndaj duhen bërë vjelje shteruese për të gjithë pasurinë e këngëve, tashmë, të dokumentuara dhe ajo, krahas studimeve të shumëfishta mbi të, patjetër duhet të zërë vend në fjalorët e ardhshëm shpjegues të shqipes.